



**Këshilli  
Shqiptar  
i Medias**



**KONRAD  
ADENAUER  
STIFTUNG**

**Raport studimor**

# **Mediat dhe informimi i qytetarëve në kohën e koronavirusit**

---

**Prof. Dr. Akademik Artan Fuga  
Prof. Assoc. Dr. Mark Marku**

**Tiranë, 2020**

Studim për standartet dhe cilësinë e informimit të qytetarëve në Shqipëri në periudhën 9 mars – 31 Maj 2020, nga kanalet televizive të vendit dhe portalet kryesore shqiptare në Web realizuar nga Këshilli Shqiptar i Medias, në bashkëpunim me Fondacionin Konrad Adenauer, Shqipëri.

EKIPI REALIZUES I PROJEKTIT:

Drejtues i projektit: Koloreto Cukali

Drejtues shkencorë dhe hartues të raportit përfundimtar:

Prof.Assoc. Dr. Mark Marku  
Prof. Dr.Akademik Artan Fuga

Grupi i monitorimit:

Lorena Memo  
Klaudia Muçollari  
Enxhi Sula

Përpunimi kompjuterik dhe vizualizimi i të dhënave:

Klejdi Eski

Design & Layout:

Grafika Elzana

Tiranë, 2020

*Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e organizatës mbështetëse, Fondacionit Konrad Adenauer Shqipëri.*

# Tabela e lëndës

---

I. Hyrje	5
II. Metodologjia e studimit	9
III. Gjetjet e studimit	18
1. Mbingopja informative për Covid 19 e kanaleve televizive dhe portaleve shqiptare.....	18
2. Diversiteti i munguar i informacionit të kanaleve televizive shqiptare gjatë periudhës së pandemisë.....	30
3. Vrasja e lajmit dhe e profesionit të gazetarit.....	50
4. Zhdukja e konferencave të shtypit. Nëse do, më ndiq në ekranin e TV-së apo në Facebook.....	64
IV. Përfundime	66



# I. Hyrje

---

Shpërthimi i pandemisë Covid 19, e gjeti sistemin mediatik shqiptar në një krizë të shumëanshme, krizë që u thellua edhe më tej dhe që pati pasoja të rënda për mediat shqiptare, me vendosjen e masave kufizuese.

Edhe pse urdhri i parë për vendosjen e masave kufizuese nga qeveria u shpall me 11 mars 2020, vetëm me 24 Mars 2020, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë me vendimin 243 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” mori një sërë masash të rrepta që synonin parandalimin e përhapjes së Covid 19. Pas këtyre masave një pjesë e aktivitetit ekonomik të bizneseve të vendit u mbyll ose u kufizua, e në këtë kuadër u kufizua edhe një pjesë e nadhe e aktivitetit të bizneseve mediatike.

Mediat e shkruara u goditën më rëndë nga masat kufizuese të shpallura nga qeveria shqiptare. Për gjithë periudhën sa zgjati gjendja e fatkeqësisë natyrore e shpallur nga qeveria, publiku shqiptar u privua nga shtypi i shkruar: gazetatat dhe revistat e vazhduan komunikimin me publikun vetëm përmes portaleve respektive. Një situatë të tillë Shqipëria dhe shqiptarët nuk e kishin përjetuar që nga botimi i gazetës së parë shqiptare “Arbëreshi i Italisë” në vitin 1848. Gazetat dhe revistat ishin botuar edhe në periudhën e dy luftërave botërore. Zhdukja gati tremujore e shtypit të shkruar përbënte një anomali për sistemin mediatik shqiptar, pasi megjithëse kjo media ishte goditur edhe më parë fillimisht me shpërthimin e televizionit e më pas me shfaqjen e teknologjive të reja të komunikimit, si rezultat i të cilave një pjesë e mirë e lexuesit kishte shtegtuar drejt medias televizive dhe drejt mediave të reja,

prapëseprapë gazeta dhe revista ishte ende pjesë e ritualit kulturor të përditshëm, të përjavshëm apo të përmujashëm të një pjese të publikut shqiptar. Me masat kufizuese ky ritual, si edhe rituale të tjera të qytetarit shqiptar u fshinë nga rutina e jetës së përditshme.

Mediat e tjera si televizioni, radio, portalet u goditën gjithashtu fort nga pikëpmaja ekonomike. Kryetari i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, Aleksandër Cipa në një deklaratë për mediat u shpreh se “Media shqiptare është sot në gjendje kolapsi, pasi të gjitha kompanitë reklamuese janë tërhequr. Asnjë biznes nuk bën reklamë në këtë kohë krize”. Rënia drastike e reklamave i cili është edhe burimi kryesor financiar i pjesës më të madhe të operatorëve audiovizivë shqiptarë çoi në mbylljen e disa emisioneve televizive dhe në transformimin e tyre duke i detyruar një pjesë të gazetarëve dhe personelit teknik të humbin vendin e punës. Të përfshirë në këtë krizë operatorët mediatikë audiovizivë ju drejtuan qeverisë me kërkesën për t’i përfshirë në paketën e ndihmës financiare. Por kryeministri Rama në një intervistë të publikuar në rrjetet sociale më 1 prill 2020, tha se “Nuk është detyra e qeverisë të financojë ecurinë e programeve komerciale. Detyra e qeverisë është që të garantojë minimumin jetik të medias për lirinë e informacionit dhe drejtës për informim”.

Përveç rreziqeve për jetën dhe vështirësive ekonomike, gazetarët shqiptarë u përballën me vështirësi që ndikuan në cilësinë, paanshmërinë dhe saktësinë e raportimit. Fillimisht ata u përballën me mungesën e besimit të institucioneve shtetërore, dhe me përpjekje direkte nga ana e qeverisë dhe kryeministrit Rama për të delegitimuar mediat si institucione të pavarura dhe të paanshme të informimit të publikut. Në një mesazh zanor të kryeministrit Rama dërguar qytetarëve shqiptarë me 12 mars kjo prirje shfaqet hapur: “Alo Edi Jam, laj duart, mos lëviz nga shtëpia për qejf, hap dritaret sa të mundesh, ruhu nga media, Ju perqafoj nga larg”.

Përpjekja për delegjtimimin e mediave konkretizohet me kufizimin e aksesit në informacion të gazetarëve. Mediat kishin si burime informacioni vetëm deklaratat e zyrtarëve të menaxhimit të krizës dhe postimet në rrjetet sociale të kryeministrit apo të funksionarëve të tjerë shtetërorë. Konferencat e shtypit me gazetarë (me prani fizike apo virtuale) u zhdukën përgjatë gjithë periudhës deri në përfundim të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, gjë që solli shmangien e gazetarit dhe gazetarisë si ndërmjetës mes informacionit dhe qytetarëve. Përqendrimi i burimeve të informacionit pakësoi në një masë të konsiderueshme mundësinë që gazetarët të merrnin informacion nga burime të ndryshme alternative.

Kjo solli përkeqësimin e cilësisë së informimit të qytetarëve dhe rrezikun në rritje për dezinformimin e qytetarëve nga qeveria, shndërrimin e mediave në instrumenta të orkestruara të propagandës dhe në cënimin e lirive themelore si e drejta e fjalës, e informimit dhe e ushtrimit të profesionit.

Shqetësimi për përpjekjen e qeverive me prirje autoritare për ta përdorur situatën e krijuar nga koronavirusi për të marrë masa shtërnguese që çenojnë parimet dhe standartet e demokracisë janë vërejtur edhe në vende të tjera të Evropës, Hungari, Serbi, Rumani etj. Duke parë këtë prirje Këshilli i Evropës nxori udhëzimin “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe demokracisë: parimet që duhet të respektojnë masat anti- koronavirus” ndërkohë që ministri i jashtëm gjerman shprehu shqetësimin për prirje të tilla në disa vende të BE-së dhe në vendet candidate për BE duke paralajmëruar se ndihmat që do të jepeshin nga BE për përballimin e situatës së krijuar nga koronavirusi “do të kushtëzohen me respektin e standarteve demokratike dhe reapektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut”.





## II. Metodologjia e studimit

Objekti i këtij studimi, të organizuar nga Këshilli Shqiptar i Medias në bashkëpunim me Fondacionin Konrad Adenauer, ishte të monitoronte dhe analizonte cilësinë dhe standartet e informimit të mediave shqiptare përgjatë periudhës së pandemisë Covid 19, më saktësisht për periudhën e karantinës së shpallur nga qeveria shqiptare nga 9 marsi deri me 31 maj 2020. Mediat e zgjedhura për monitorim ishin kanalet kombëtare dhe kanalet kryesore me informacion të pandërprerë si dhe disa nga portalet kryesore. Ishin pikërisht këto media që mbajtën edhe peshën kryesore të informimit të publikut gjatë pandemisë së koronavirusit.

Kanale televizive	Portalet
<i>Top Channel</i>	<i>Panorama Online</i>
<i>TV Klan</i>	<i>Balkan Web</i>
<i>TVSH</i>	<i>Syri.net</i>
<i>Vizion Plus</i>	<i>gazetadita.al</i>
<i>News 24</i>	<i>Dosja.al</i>
<i>Ora News</i>	<i>Lapsi.al</i>
<i>ABC News</i>	<i>Exit.al</i>
<i>Report TV</i>	<i>Sot.com.al</i>
<i>A2 CNN</i>	<i>Gazetatema.al</i>
<i>Euronews</i>	

**Tabela 1:** Kanalet televizive dhe portalet e monitoruara

Nga kanalet televizive u zgjedhën për monitorim pjesa e programacionit e përbërë nga edicionet e lajmeve, emisionet e mëngjesit si dhe emisionet e talkshow-t politik.

Media	Emisione mëngjesi	Emisione politikë
<i>Top Channel</i>	Wake Up	Open (4 herë në javë)
<i>TV Klan</i>		Opinion (4 h/j) Zonë e Lirë (1 h/j)
<i>TVSH</i>	Mirëmëngjes Shqipëri	Përballë (1 h/j)
<i>Vizion Plus</i>	7 pa 5	Kapital (1 h/j)
<i>News 24</i>		Real Story (4 h/j)
<i>Ora News</i>	Ora Juaj	360 gradë (2 h/j) Tempora (1 h/j) Arena (1 h/j)
<i>ABC News</i>	ABC-ja e mëngjesit	Provokacja (1 h/j)
<i>Report TV</i>		Repolitix (2h/j)
<i>A2 CNN</i>	Dita Jonë	
<i>Euronews</i>	Goodmorning Albanians	Ilva Now (5 h/j)

**Tabela 2:** *Emisionet e monitoruara*

Monitorimi synonte të mbliidhte njëherësh të dhëna sasiore dhe cilësore. Të dhënat sasiore do të na jepnin një pamje sa më të qartë të vendit që zuri informacioni mbi Covid 19 në programacionin e kanaleve televizive të monitoruara, të raporteve mes informacionit nga vendi dhe nga bota, por edhe do të na jepnin mundësinë për të analizuar mënyrën dhe aftësinë e kanaleve televizive për të reaguar në kohë krize dhe për të përmbushur misionin e tyre në shërbim të informimit të publikut.

Ndërkohë që monitorimi i të dhënave cilësore do të na ndihmonte për të bërë një analizë të standardeve profesionale të informacionit televiziv. Kjo, e parë nga disa parametra ndërkombëtarisht të njohur dhe po aq ndërkombëtarisht të pranuar që shërbejnë si kritere për performancën informative të mediave televizive që sipas studiesit D. McQuail janë:

- a. Liria e mediave me komponentë të saj si: pavarësia, aksesit teknologjik, diversiteti i ofertës informative
- b. Pavarësia, që do të thotë pavarësi (e gazetarëve): nga pronarët, qeveria, shtrëngimet e brendshme (në redaksi), publiciteti, burimet, grupet e presionit që do të thotë liri për: aktivitetin krijues, mbrojtje, rol kritik, diversitet.
- c. Paanshmëria: referimi ndaj fakteve, mospërfshirja në krah të palëve
- d. Diversiteti

Për këtë qëllim u përpunua një skedë metodologjike monitorimi, që do t'u shërbente monitoruesve të mblidhnin të dhënat e domosdoshme për analizën sasiore dhe analizën e standarteve profesionale. Sipas kësaj skede monitorimi, u monitoruan këto parametra profesionale në edicionet informative:

### 1. **Numri i lajmeve**

- a. Numri i lajmeve në një edicion
- b. Numri i lajmeve për Covid 19
- c. Numri i lajmeve të huaja për Covid 19

### 2. **Burimet e informacionit**

- a. Deklaratë zyrtare (Ministria, ISHP, Spitali)
- b. Deklaratë në FB/Tweetter/Instagram e Kryeministrit
- c. Deklaratë në FB/Tweetter/Instagram e Institucioneve Qeveritare (Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, ISHP, etj)
- d. Kronikë/reportazh nga terreni (spitale, pika kufitare, etj)
- e. Informacione zyrtare nga nëpunës të institucioneve të menaxhimit të epidemisë (mjekë, epidemiologë, etj)
- f. Konferenca shtypi me gazetarë
- g. Deklarata në FB të opozitës
- h. Deklarata zyrtare të opozitës
- i. Media qytetare (blogje, FB, etj)

- j. Dëshmi nga të sëmurë, familjarë
- k. Lajme investigative

### 3. Të ftuarit në edicion lajmesh:

- a. Qeveritarë dhe politikanë të partisë në pushtet
- b. Nëpunës i institucioneve të menaxhimit të epidemisë
- c. Ekspertë (mjekë, epidemiologë, psikologë, etj)
- d. Politikanë të opozitës
- e. Dëshmi (të sëmurë, familjarë, etj)
- f. Shoqëri civile
- g. Të tjerë
- h. Nuk ka të ftuar

Ndërkohë monitorimi i emisioneve të mëngjesit dhe të emisioneve talkshow, u përqendrua në parametra të tillë si:

#### 1. Numri i temave

- a. Numri i emisioneve të monitoruara
- b. Numri i temave për Covid 19

#### 2. Profili i të ftuarve në emision:

- a. Kryeministri
- b. Qeveritarë dhe politikanë të partisë në pushtet
- c. Nëpunës të institucioneve të menaxhimit të epidemisë
- d. Ekspertë: mjekë, epidemiologë, etj.
- e. Politikanë të opozitës
- f. Gazetarë në terren
- g. Shoqëri civile në Shqipëri
- h. Të sëmurë dhe familjarë të sëmuresh në Shqipëri
- i. Publik në Shqipëri
- j. Shqiptarë rezidentë jashtë Shqipërisë
- k. Analist i përhershëm në emision
- l. Të tjerë

### 3. Të dhëna:

#### a. A përdoren statistikat në emision

- a. Po
- b. Jo

#### b. Nga vijnë të dhënat:

- a. Zyrtare (Qeveria, Ministritë, ISHP, Instat)
- b. Institucionet autonome (Akademia e Shkencave)
- c. Institucionet e opozitës (partitë)
- d. Pushteti lokal (bashkitë, spitalet rajonale)
- e. Të dhëna të pavarura nga individë (ekspertë, gazetarë, etj)

#### c. A diskutohet vetëm mbi të dhëna zyrtare:

- a. Po
- b. Jo

Siç shihet edhe nga skeda e monitorimit u mblodhën të dhëna që na bënë të mundur të verifikonim rolin e mediave në informimin e publikut në Shqipëri, në kohën e Covid 19 ose e thënë ndryshe kapacitetin e saj për të prodhuar përmbajtje të ndryshme nga ato që prodhojnë burimet zyrtare si insitucionet qeveritare dhe publike, aftësinë për t'i verifikuar burimet zyrtare dhe ballafaqimin e tyre me burime alternative, saktësinë e informacionit të prodhuar nga kanalet televizive, pavarësinë ose varësinë e këtyre mediave nga politika, etj.

Të dhënat e mbledhura na mundësuan gjithashtu të analizojmë dy dukuri shumë të diskutuara për median shqiptare edhe para pandemisë. E para, problemi i shndërrimit të mediave shqiptare në riprodhuese të përmbajtjeve të emetuara nga zyrat e PR-it të kryeministrit, të partive politike dhe institucioneve. Kjo dukuri është shfaqur me kohë në mediat shqiptare por në vitet e fundit është bërë veçanërisht shqetësuese. Dihet se mediat kryesore të vendit

dhe edicionet kryesore informative, në vend që të informojnë për veprimtarinë e qeverisë qendrore dhe lokale apo të partive politike në mënyrë të paanshme, i marrin të gatshme “lajmet” e tyre nga zyrat e PR-it dhe ia servirin publikut si “lajme mediatike”. Kjo ka sjellë jo vetëm reduktimin deri në zhdukje të lajmit si gjini bazë e raportimit në media dhe zëvendësimin e tij me komunikimet e PR-it, por edhe zhdukjen e rolit të medias si pushtet kontrollues i katër pushteteve. Kjo bën pastaj që pushteti i pestë-publiku të humbë besueshmërinë tek mediat tradicionale dhe të ndërtojë një sistem të vetin mediatik paralel të komunikimit përmes mediave sociale.

Nga ana tjetër, përmes të dhënave të nxjerra nga monitorimi krijohet edhe një përceptim për marrëdhënien e mediave tradicionale apo të reja me mediat sociale, marrëdhënie që e ka transformuar totalisht marrëdhënien e qytetarit modern me median. I gjendur tradicionalisht para një media që ishte e vetmja alternativë për informimin mbi realitetet shoqërore, publiku tradicional mund ta snobonte informacionin e ardhur nga mediat por, nuk kishte asnjë mundësi të bëhej aktor me ndikim në sistemin e komunikimit masiv të shoqërisë. Zhvillimet teknologjike i kanë krijuar atij mundësinë të ketë në dorë edhe kameran, edhe mikrofonin, edhe tastierën e shkrimit në dispozicion, dhe si i tillë ai nuk është më vetëm konsumator, por edhe prodhues përmbajtjesh. Një shoqëri e rrjetëzuar, që informon dhe informohet është krejt e ndryshme nga shoqëria para teknologjike. Sistemi mediatik, shoqëria, individi i kanë ndryshuar raportet mes tyre. Sistemi mediatik e ndien presionin e kësaj shoqërie të rrjetëzuar që prodhon përmbajtje informatike në mënyrë të pandërprerë dhe mundohet shpeshherë ta përfshijë këtë informacion në masën e informacionit që prodhon vetë. Problemi ishte të shikonim deri në ç’pikë, kjo shoqëri e rrjetëzuar që tashmë po konsiderohet si pushteti i pestë, e korigjon apo i bën presion pushtetit të katërt në kohën kur ky i fundit vihet në shërbim të pushteteve të tjera, duke devijuar nga funksioni i tij bazë: informimi i publikut?

Nga ana tjetër përmes monitorimit synohej të verifikohesh se si komunikimi i aktorëve politike e shfrytëzon sistemin alternativ të informimit të rrjeteve sociale për të shmangur mediat tradicionale si ndërmjetësues mes aktorëve politikë dhe publikut duke hyrë vetë në marrëdhënie të drejpërdrejtë me të. Në këtë drejtim do të na ndihmonte monitorimi i komunikimeve përmes rrjeteve sociale të qeverisë, kryesisht të përfaqësuar nga kryeministri si dhe të institucioneve të tjera publike, apo të aktorëve politikë opozitarë.

Monitorimi i portaleve, synonte gjithashtu evidentimin e parametrave të përmendur më sipër, natyrisht duke pasur parasysh specifikat e tyre si media, por edhe specifikat e tyre si media shqiptare. Informacioni që këto portale prodhojnë vjen sa nga rrjetet sociale, aq edhe nga televizioni dhe si të tilla ato shfaqen me përparësi, por edhe me problemet që ka informacioni i prodhuar nga mediat e tjera.

Në këtë kuptim ato janë ende më shumë një kontejner i informacionave të ardhura nga drejtime të ndryshme se sa një media e konsoliduar, me parime dhe standarde profesionale të vetat, me formate dhe gjini informative të transformuara. Ndoshta e vetmja karakteristikë e tyre për momentin është të qenit një hapësirë multimediale komunikimi ku ndërthuren karakteristika të mediave të ndryshme. Thënë kjo, analiza e portaleve iu nënshtrua monitorimit të këtyre parametrave:

### **1. Aktualiteti, nga merret informacioni për COVID:**

- a. Nga programet, intervistat dhe lajmet në TV
- b. Nga konferencat për shtyp
- c. Nga deklaratat zyrtare të institucioneve (Ministria, Kryeministria, ISHP, etj)
- d. Nga parlamenti
- e. Nga deklaratat në FB të KM
- f. Nga deklaratat FB të Institucioneve

- g. Nga postimet në FB/tweetter/instagram të politikanëve
- h. Nga postimet në FB/tweetter/instagram të ekspertëve
- i. Nga deklaratat/komentet në FB të njerëzve të zakonshëm
- j. Materiale të përkthyer nga media të huaja

## 2. Opinione, janë shkruar nga:

- a. Mjekë
- b. Ekspertë të epidemiologjisë
- c. Studiues të shkencave sociale
- d. Opinionistë e kolumnistë të rregullt
- e. Marrë nga media të huaja
- f. Politikanë
- g. Gazetarë
- h. Të tjerë
- i. Marrë nga FB-u i autorëve

Por ky studim përveç vështirësive me të cilat përballet çdo studim, ka hasur në vështirësi shtesë, dhe autorëve të këtij studimi u është dashur të përballen me disa sfida që lidhen me kohën e pazakontë kur u realizua ky studim, me sasinë e madhe të përmbajtjeve mediatike të monitoruara, por edhe natyrën specifike të tij dhe të dukurive që shfaqen përmes monitorimit. Për herë të parë në historinë e vendit, kemi një situatë të kufizimit të aktivitetit mediatik për "shkaqe objektive" të pranuar gjerësisht nga shoqëria. Problemi ishte të dalloje dukuritë normale mediatike në një gjendje anormale, pra dukuritë mediatike universalisht të shfaqura në të gjitha sistemet demokratike gjatë pandemisë, nga dukuritë specifike shqiptare, domethënë përpjekjet që u bënë në sistemet demokratike hibride për t'i përdorur sistemet mediatike në funksion të kontrollit të informacionit nga ana e qeverive dhe në rastet më ekstreme të përdorimit të mediave për manipulimin e opinionit publik. Me qëllimin për të arritur në rezultate sa më të besueshme autorët e këtij studimi u mbështetën në metodologjinë e paraqitur më sipër: monitorim i përmbajtjeve mediatike të prodhuara gjatë



kohës së pandemisë mbi bazën e parametrave dhe standarteve profesionale universalisht të njohura dhe të pranuara që aplikohen për cilësinë e informacionit mediatik, përpunim dhe vizualizim i të dhënave, analizë e tyre dhe identifikim i dukurive.

# III. Gjetjet e punimit

---

## 1. Mbingopja informative për Covid 19 e kanaleve televizive dhe portaleve shqiptare.

Të dhënat sasiore të nxjerra nga monitorimi tregojnë se gjatë gjithë periudhës së karantinimit drastik të periudhës 9 mars-31 maj shqiptarët e mbyllur në shtëpitë e tyre janë bombarduar me një masë shumë të madhe informacioni mbi Covid 19. Nga gjendjet e fatkeqësisë natyrore, padyshim pandemia Covid 19 ka qenë ndër më të raportuarat në rang botëror dhe rasti i Shqipërisë nuk përbën risi në këtë drejtim. Të gjitha mediat pa përjashtim, kanë pasur si kryetëmë përhapjen e pandemisë dhe kjo është përcaktuar nga “vlerat” e jashtëzakonshme lajmore që u ofronte kjo ngjarje mediave, vlera që lidhen me ndikimin dhe pasojat që ngjarja kishte në jetën e njërëzve. Nga pikëpamja e raportimit, një pandemi si Covid 19 përmban gjithçka të denjë për t’u raportuar: ajo përbënte një rrezik total, për jetën biologjike por edhe gjendjen ekonomike e sociale të individit dhe shoqërisë. Gjithë jeta e re nën masat e marra për parandalimin e Covid 19 ishte diçka e panjohur më parë. Për këtë arsye, mediat natyrshëm e konsiderojnë Covid 19 dhe gjithçka lidhet me të si kryengjarje dhe e shndërrojnë në kryelajm. Por, kjo ende nuk do të thotë asgjë për cilësinë dhe standartet e informimit në kohën e pandemisë. Madje në vetvete kjo përbën një paradox. Pikërisht një ngjarje kaq e zgjatur në pasoja dhe ndikim, kaq “e pasur” me informacion nuk mund të raportohet siç duhet. Vetë pandemia për natyrën e saj goditëse ndaj jetës së secilit, vë në diskutim aftësitë bazë të profesionit të gazetarit: të qenit në vendgjarje dhe raportimin nga terreni. Gazetarët shkojnë në luftë dhe raportojnë nga terreni përkundër rrezikut. Por, gazetarët e


kanë të vështirë të depërtojnë aty ku zhvillohet beteja me Covid 19, thjeshtë sepse nuk mund të hyjnë atje. Gazetarët mund të raportojnë shifra, me vdekjet, me të prekurit nga Covidi, por në pjesën më të madhe të rasteve nuk mund t'i verifikojnë ato shifra.

Siç shihet edhe nga monitorimi mediat shqiptare kanë prodhuar një masë relativisht të madhe informacioni për Covid 19. Tabelat e mëposhtme tregojnë se lajmet për Covid 19 zenë në të gjitha edicionet e lajmeve të kanaleve kombëtare dhe të kanaleve me informacion të pandërprerë thuajse  $\frac{3}{4}$ -t e sasisë së informacionit të prodhuar në këtë periudhë.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM					
Media	Edicione lajmesh	Nr total i lajmeve të monitoruara për periudhën	Nr mesatar i lajmeve në edicion	Nr i lajmeve të huaja për Covid-19	Nr i lajmeve për Covid-19
RTSH	84	1050	13	231	551
TV Klan	84	1300	15	345	547
Top channel	83	1764	21	301	598
News 24	81	1656	20	293	722
Vizion +	80	1073	13	168	470
ABC News	79	1461	18	280	704
ORA News	77	958	12	226	464
Euro News	71	1037	15	264	447
Report TV	61	896	15	85	553

**Tabela 3:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19, si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të kanaleve televizive shqiptare

Diagrama 1.A-1



**Diagrama 1:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19, si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të kanaleve televizive shqiptare

Duke bërë një krahasim të të dhënave të mbledhura nga monitorimi siç e thamë më sipër vihet re se sasia e lajmeve për Covid 19 krahasuar më lajmet të tjera për ngjarje që nuk lidhen me Covid 19 është dukshëm në favor të Covid 19. E shndërruar në përqindje siç do të shihet nga tabelat dhe grafikët e mëposhtëm vihet re se përgjatë gjithë periudhës së karantinës në edicionet informative të kanaleve të marra në total vetëm 34% e gjithë sasisë së lajmeve janë për fusha dhe çështje që nuk kanë të bëjnë me Covid 19. Ndërkohë që 66% e totalit të lajmeve mbulojnë fushën e Covid 19. Kjo shpjegohet jo vetëm me rëndësinë e ngjarjes, por edhe me faktin se një pjesë e jetës shoqërore ishte totalisht ose pjesërisht e paralizuar në këtë periudhë. Lajme nga fusha të tilla si politika, kultura, sporti, jeta sociale nuk mund të kishte për shkak

të pezullimit total të veprimtarive në këto fusha. Po, ashtu në këtë periudhë janë pothuajse inekzistente lajmet e kronikës së zezë, për shkak të mungesës së qarkullimit në akset rrugore të vendit e po ashtu mungojnë raportimet nga fusha e kimit të organizuar gjithashtu për shkak të pamundësisë për të qarkulluar. E vetmja fushë që mund të prodhonte lajme ishte mjekësia dhe deri diku ekonomia.


Në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm do të shihet jo vetëm raporti mes lajmeve për Covid 19 dhe lajmeve të tjera në secilin prej kanaleve televizive të monitoruara por edhe raporti mes lajmeve për Covid 19 nga vendi dhe bota. Për shkak të natyrës së pandemisë - një kërcënim global që preku të gjitha vendet e globit pa përjashtim, thuajse me të njëjtat ritme dhe në të njëjtën kohë, lajmet dhe informacioni global u përhapën si asnjëherë tjetër.

Të ndihmuara edhe nga infrastruktura globale e teknologjive të reja, këto lajme u bënë si asnjëherë tjetër pjesë e jetës së përditshme të realiteteve lokale. Si asnjëherë tjetër bota u shndërrua realisht në “global village-n” e McLuhanit. Mediat shqiptare të karakterizuara nga një “izolacionizëm” i fortë në raport me botën, ku më parë thuajse mungonin tërësisht mbulimet me korrespondentë të tyre të ngjarjeve ndërkombëtare, madje me një raport shumë të zbalancuar të ngjarjeve ndërkombëtare në edicionet e tyre informative, e “globalizuan” informacionin e tyre. Ky kontekstualizim ndërkombëtar i informacionit lokal nuk kishte ndodhur më parë.

RTSH, transmetuesi publik shqiptar raportimin për Covid 19 nga vendi dhe bota e kishte në raportin 52% me 22%, raport ky që tregon se informacioni ndërkombëtar zuri një vend të konsiderueshëm në operatorin publik. Ndërkohë që në totalin e përgjithshëm lajmet ndërkombëtare dhe të vendit në transmetuesin publik për Covid 19 janë 74%. Vetëm 26% e lajmeve të RTSH-së mbulojnë ngjarje që nuk lidhen me Covid 19.

RTSH				
Media	Nr i lajmeve të huaja për Covid-19	Nr i lajmeve vendas për Covid-19	Nr i lajmeve JO për Covid-19	Nr total i lajmeve të monitoruara për periudhën 9 mars - 30 maj
RTSH	231	551	268	1050

**Tabela 4:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të RTSH




**Diagrama 2:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të RTSH.

Në kanalin televiziv kombëtar Klan, vihet re se përqindja e lajmeve për Covid 19 në total nga vendi është 42%, ndërkohë që numri i lajmeve ndërkombëtare për Covid 19 është relativisht i lartë 27%. Po kështu sasia e lajmeve që mbulojnë fusha të tjera është relativisht i lartë krahasuar me kanalet e tjera televizive: 31%.

TV Klan				
Media	Nr i lajmeve të huaja për Covid-19	Nr i lajmeve vendas për Covid-19	Nr i lajmeve JO për Covid-19	Nr total i lajmeve të monitoruara për periudhën 9 mars - 30 maj
TV Klan	345	547	408	1300

**Tabela 5.** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të TV Klan




**Diagrama 3:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19, si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të TV Klan

Kanali televiziv kombëtar Top Chanel, e ka më të balancuar informacionin për Covid 19 dhe informacionin për ngjarje të tjera përtej Covid 19. Lajmet për Covid 19 këtu zënë 51% të të gjitha lajmeve të transmetuara nga ky kanal. Në këtë drejtim ai përbën një përjashtim krahasuar me kanalet e tjera. Ndërkohë që ndryshe nga kanalet e tjera edhe përqindja e lajmeve nga bota për Covid 19 është më e ulët: 17%.

Top Channel				
Media	Nr i lajmeve të huaja për Covid-19	Nr i lajmeve vendase për Covid-19	Nr i lajmeve JO për Covid-19	Nr total i lajmeve të monitoruara për periudhën 9 mars - 30 maj
Top channel	301	598	865	1764

**Tabela 6:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve në Top Chanel




**Diagrama 4:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve në Top Channel

Kanali televiziv tjetër kombëtar gjeneralist Vizion + ka gjithashtu një raport të balancuar mes lajmeve për Covid 19 dhe lajmeve të tjera. Nga monitorimi rezulton se ky raport është 40% me 60%, në favor të lajmeve për Covid 19. Edhe sasia e lajmeve nga aktualiteti ndërkombëtar për Covid 19 është më i ulët se në kanalet e tjera: 16%.



VIZION +				
Media	Nr i lajmeve të huaja për Covid-19	Nr i lajmeve vendase për Covid-19	Nr i lajmeve JO për Covid-19	Nr total i lajmeve të monitoruara për periudhën 9 mars - 30 maj
Vizion +	168	470	435	1073

**Tabela 7:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të Vizion +




**Diagrama 5:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të Vizion +

Tabelat dhe grafikët e mëposhtëm japin rezultatet e monitorimit të kanaleve informative shqiptare. Nga këto kanale janë monitoruar gjithashtu vetëm edicionet kryesore informative. Kanali televiziv News 24 rezulton se ka pak a shumë të njëjtin raport me kanalin televiziv Vizion + për sa i përket lajmeve që mbulojnë situatën e Covid 19 krahasuar me lajmet e tjera, pra ky raport është 40% me 60% në favor të lajmeve për Covid 19.

News 24				
Media	Nr i lajmeve të huaja për Covid-19	Nr i lajmeve vendase për Covid-19	Nr i lajmeve JO për Covid-19	Nr total i lajmeve të monitoruara për periudhën 9 mars - 30 maj
News 24	293	722	641	1656

**Tabela 8:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve në News 24

1.A-6  
News 24




**Diagrama 6:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të News 24.

Kanali televiziv ABC News i cili ka pak a shumë të njëjtën strukturë programore me News 24 është më shumë i fokusuar tek raportimi i situatës së pandemisë, lajmet për pandeminë në ABC News zënë 67% të informacionit të përgjithshëm.

ABC News				
Media	Nr i lajmeve të huaja për Covid-19	Nr i lajmeve vendase për Covid-19	Nr i lajmeve JO për Covid-19	Nr total i lajmeve të monitoruara për periudhën 9 mars - 30 maj
ABC News	280	704	477	1461

**Tabela 9:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të ABC News

**1.A-8**  
ABC News




**Diagrama 7:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të ABC News

Kanali televiziv Ora News ka një raport më të zhbalancuar mbulimi për ngjarjet e tjera përtej Covid 19, këto lajme zënë vetëm 33%, ndërkohë që 67% e lajmeve të tij mbulojnë Covid 19, prej të cilave 48% mbulojnë situatën e pandemisë në Shqipëri dhe 24% situatën pandemike globale.

Ora News				
Media	Nr i lajmeve të huaja për Covid-19	Nr i lajmeve vendase për Covid-19	Nr i lajmeve JO për Covid-19	Nr total i lajmeve të monitoruara për periudhën 9 mars - 30 maj
Ora News	226	464	268	958

**Tabela 10:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të Ora News




**Diagrama 8:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të Ora News

Kanali televiziv Euro News është thujse në të njëjtat raporte:

Euro News				
Media	Nr i lajmeve të huaja për Covid-19	Nr i lajmeve vendase për Covid-19	Nr i lajmeve JO për Covid-19	Nr total i lajmeve të monitoruara për periudhën 9 mars - 30 maj
Euro News	264	447	326	1037

**Tabela 11:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të Euro News

1.A-10  
Euro News




**Diagrama 9:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të Euro News

Kanali televiziv Report TV shfaqet me raporte thuajse të njëjta për sa i përket raportit mes lajmeve për Covid 19 (71%) dhe lajmeve të tjera (29%), por në ndryshim nga kanalet e tjera, sasia e informacionit nga situata pandemike në botë ky kanal televiziv ka përqindjen më të ulët: vetëm 9% e lajmeve janë informacione nga bota.

Report TV				
Media	Nr i lajmeve të huaja për Covid-19	Nr i lajmeve vendase për Covid-19	Nr i lajmeve JO për Covid-19	Nr total i lajmeve të monitoruara për periudhën 9 mars - 30 maj
Report TV	85	553	258	896

**Tabela 12:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të Report TV

### 1.A-11 Report TV



**Diagrama 10:** Raporti mes lajmeve nga vendi dhe bota për pandeminë Covid 19 si dhe lajmeve të tjera në edicionet e lajmeve të Report TV

## 2. Diversiteti i munguar i informacionit të kanaleve televizive shqiptare gjatë periudhës së pandemisë

Të dhënat e mësipërme për raportet mes lajmeve për Covid 19 dhe lajmeve të tjera në kanalet televizive shqiptare thonë pak ose aspak për cilësinë e lajmeve përgjatë periudhës së masave kufizuese. Mbiraportimi për Covid 19, tregon se informimi i shoqërisë nga mediat u godit në një nga parametrat themelorë të cilësisë së

informacionit: diversitetin e informacionit. Diversiteti ka të bëjë kryesisht me pluralizmin tematik të lajmeve të prodhuara nga mediat që i përgjigjen diversitetit të ngjarjeve që prodhon shoqëria, rrjedhimisht interesit të çdo qytetari për t'u njohur me ngjarjet të shumta, plurale që rrokin gjithë spektrin e jetës shoqërore, përfshi këtu edhe raportimin për interesa, dukuri dhe trende që lidhen me grupet minoritare të shoqërisë. Nga monitorimi zbulohet një raportim monokron i realitetit shoqëror. Siç do të shihet edhe nga rezultatet e monitorimit, në lajmet televizive shqiptare, mbizotëron raportimi për menaxhimin e situatës nga qeveria dhe institucionet shtetërore të caktuara për menaxhimin e pandemisë. Mungon thuajse fare, informimi për kapacitetet e spitaleve, për numrin e mjekëve dhe të infermierëve në dispozicion, për kushtet spitalore, numrin e tamponeve, për vështirësitë e qytetarëve shqiptarë dhe gjendjen e tyre ekonomike, ndikimin psikologjik të këtyre ndryshimeve në jetën e fëmijëve, të moshuarve dhe të grupeve të ndryshme sociale. Kryetëmë dhe shpeshherë temë e vetme ishte puna e qeverisë për menaxhimin e situatës së pandemisë.

Por diversiteti i lajmeve varet shumë edhe nga personat përfaqësues që flasin në edicionet informative, gjë që ndikon në mënyrën se si publiku i lexon lajmet. Sa më pak diversitet në përfaqësimin mediatik, aq më pak këndvështrime në përthyerjen e informacionit të transmetuar. Kjo çënon rëndë edhe pluralizmin e ideve dhe të debatit mediatik.

Monitorimi e tregon qartë këtë deformim në informimin e publikut.

I ftuari është:	RTSH	TV Klan	Top channel	News 24	Vizion +	ABC News	ORA News	Euro News	Report TV
Qeveritar/politikan i Partisë në pushtet	1	3	2	11	10	8	11	9	4
Nëpunës i institucioneve të menaxhimit të epidemisë	1	0	2	3	8	1	9	5	1
Ekspert (mjek, psikolog, epidemiolog, etj)	6	11	5	4	19	12	24	22	7
Politikan i opozitës	1	0	1	2	4	12	5	6	6
Dëshmitar (i sëmurë, familjar)	0	0	0	1	0	2	0	1	4
Shoqëri civile	0	0	0	1	0	3	2	4	1
Të tjerë	0	1	5	10	10	9	17	13	6
Nuk ka të ftuar	72	51	15	37	29	29	15	23	24
Lidhje Skype me jashtë Shqipërisë	0	20	57	30	4	12	19	15	8

**Tabela 13:** Të ftuarit në edicione lajmesh



DIAGRAMA 1.C

■ qeveritar/politikan i Partisë në pushtet  
 ■ dëshmitar (sëmurë, familjar)  
 ■ ekspert (mjek, psikolog, epidemiolog, etj)  
 ■ shqiptari civilë  
 ■ nuk ka të ftuar  
 ■ të tjerë  
 ■ politikan i opozitës  
 ■ lloji i Skype me jashtë Shqipërisë




Diagrama nr. 11. Të ftuarit në edicione lajmesh

Siç shihet nga tabela dhe diagrama e mësipërme ka një disproporcion të madh mes nivelit të përfaqësimit të kategorive si qeveritar/politikan i partisë në pushtet, nëpunës i institucioneve të menaxhimit të epidemisë, ekspert (mjek, psikolog, epidemiolog, etj) dhe kategorive të tjera si politikan i opozitës, dëshmitarë (i sëmurë, familjar), shoqëri civile dhe kategori të tjera profesionale apo sociale.


Duket qartë se në edicionet informative është rritur ndjeshëm prania e ekspertit nga fusha e mjekësisë dhe kjo është e kuptueshme. Po të kemi parasysh edhe faktin se pjesa më e madhe e kategorisë së shënuar në monitorim si lidhje me skype me jashtë, janë mjekë dhe kërkues shkencorë shqiptarë që punojnë në institucione mjekësore apo kërkimore jashtë vendit ky përfaqësim bëhet edhe më i ndjeshëm.

Përfaqësimi i shtuar i ekspertëve të mjekësisë në edicionet informative, bashkë me përfaqësuesit e institucioneve të ngarkuara me menaxhimin e pandemisë si dhe figurat përfaqësuese të qeverisë tregon përpjekjen e mediave për t'u fokusuar kryesisht në aspektin teknik të pandemisë dhe në atë të menaxhimit. Informacioni për Covid 19 i shoqëruar edhe me një diksurs shkencor të divulguar e bën informacionin për pandeminë të mangët dhe të shpjeguar vetëm në një ose pak këndvështrime.

Siç shihet nga monitorimi, në edicionet informative mungon thuajse tërësisht përfaqësimi i palëve si dëshmitarë, shoqëri civile, dhe të tjerë, por edhe i problematikës që lidhet me këto kategori.

I ftuari është:	RTSH	TV Klan	Top channel	News 24	Vizion +	ABC News	ORA News	Euro News	Report TV
Dëshmitar (i sëmurë, familjar)	0	0	0	1	0	2	0	1	4


**Tabela 14:** Të ftuarit në edicione lajmesh nga kategoria dëshmitarë (i/e sëmurë, familjar etj.)



**Diagrama 12:** Të ftuarit në edicione lajmesh nga kategoria dëshmitarë (i/e sëmurë, familjar etj.)

I ftuari është:	RTSH	TV Klan	Top channel	News 24	Vizion +	ABC News	ORA News	Euro News	Report TV
Shoqëri civile	0	0	0	1	0	3	2	4	1


**Tabela 15:** Të ftuarit në edicione lajmesh nga shoqëria civile

1.C-15  
shoqëri civile**Diagrama 13:** Të ftuarit në edicione lajmesh nga shoqëria civile

Në transmetuesin publik RTSH, ka një barazi mes të ftuarve nga ana e opozitës dhe pozitës, më shumë të ftuar si ekspertë, por mungojnë krejtësisht të ftuarit nga kategoritë e tjera si dëshmitarë, shoqëri civile dhe përfaqësues nga kategori të tjera profesionale apo shoqërore. Në RTSH, numri i të ftuarve është i vogël krahasuar me kanalet e tjera televizive.

i ftuari është:	RTSH
qeveritar/politikan i partisë në pushtet	1
nëpunës i institucioneve të menaxhimit të epidemisë	1
ekspert (mjek, psikolog, epidemiolog, etj)	6
politikan i opozitës	1
dëshmitar (i sëmurë, familjar)	0
shoqëri civile	0
të tjerë	0
nuk ka të ftuar	72
lidhje Skype me jashtë Shqipërisë	0

**Tabela 16:** Të ftuarit në edicione lajmesh në RTSH




**Diagrama 14:** Të ftuarit në edicione lajmesh në RTSH

Kanali televiziv kombëtar Klan ka të ftuar kryesisht ekspertë të mjekësisë, ndonjë qeveritar apo politikan të partisë në pushtet, dhe asnjë të ftuar nga shoqëria civile, dëshmitarë si të sëmurë apo të afërm të tyre apo të ftuar nga fushat e tjera si ekonomia, arsimi, apo kategori të tjera profesionale apo shoqërore.

i ftuari është:	TV Klan
qeveritar/politikan i partisë në pushtet	3
nëpunës i institucioneve të menaxhimit të epidemisë	0
ekspert (mjek, psikolog, epidemiolog,etj)	11
politikan i opozitës	0
dëshmitar (i sëmurë, familjar)	0
shoqëri civile	0
të tjerë	1
nuk ka të ftuar	51
lidhje Skype me jashtë Shqipërisë	20

**Tabela 17:** Të ftuarit në edicione lajmesh në TV Klan




**Diagrama 15:** Të ftuarit në edicione lajmesh në TV Klan

Top Channel bie në sy për numrin e madh të të ftuarve me skype nga ekspertë shqiptarë që punojnë jashtë vendit si mjekë dhe kërkues shkencorë. Numri i tyre (57), kontraston dukshëm me numrin e ekspertëve vendas (5), por edhe me numrin e pakët të përfaqësuesve të insitucioneve që menaxhojnë pandeminë në Shqipëri. Ndërkohë kategoritë e tjera mungojnë mes personave të ftuar të edicioneve informative të këtij kanali.

i ftuari është:	Top Channel
qeveritar/politikan i partisë në pushtet	2
nëpunës i institucioneve të menaxhimit të epidemisë	2
ekspert (mjek, psikolog, epidemiolog, etj)	5
politikan i opozitës	1
dëshmitar (i sëmurë, familjar)	0
shoqëri civile	0
të tjerë	5
nuk ka të ftuar	15
lidhje Skype me jashtë Shqipërisë	57

**Tabela 18.** Të ftuarit në edicione lajmesh në Top Channel

1.C-3  
Top channel




**Diagrama 16.** Të ftuarit në edicione lajmesh në Top Chanel

Kanali tjetër kombëtar Vizion Plus, ka një numër të madh të ftuarish nga përfaqësues zyrtarë të qeverisë dhe të institucioneve të menaxhimit të pandemisë (18), përkundrejt 19 ekspertëve të ftuar edhe ata kryesisht të punësuar në këto institucione, por pa attribute zyrtare përfaqësimi. Ndërkohë që kategoritë e tjera janë kryesisht të papërfaqësuar.

i ftuari është:	Vizion +
qeveritar/politikan i partisë në pushtet	10
nëpunës i institucioneve të menaxhimit të epidemisë	8
ekspert (mjek, psikolog, epidemiolog, etj)	19
politikan i opozitës	4
dëshmitar (i sëmurë, familjar)	0
shoqëri civile	0
të tjerë	10
nuk ka të ftuar	29
lidhje Skype me jashtë Shqipërisë	57

**Tabela 19.** Të ftuarit në edicione lajmesh në Vizion Plus



**Diagrama 17.** *Të ftuarit në edicione lajmesh në Vizion +*


Në News 24 vihet re një prani më e madhe e figurave politike, e përfaqësuesve të institucioneve të menaxhimit të pandemisë si dhe një prani gjithashtu e madhe e ekspertëve shqiptarë në lidhje skype nga jashtë Shqipërisë. Por në ndryshim nga kanalet e tjera numri i të ftuarve nga fusha të tjera është më i lartë (12).

i ftuari është:	News 24
qeveritar/politikan i partisë në pushtet	11
nëpunës i institucioneve të menaxhimit të epidemisë	3
ekspert (mjek, psikolog, epidemiolog, etj)	4
politikan i opozitës	2
dëshmitar (i sëmurë, familjar)	1
shoqëri civile	1
të tjerë	10
nuk ka të ftuar	37
lidhje Skype me jashtë Shqipërisë	30

**Tabela 20.** *Të ftuarit në edicione lajmesh në News 24*



1.C-4  
News 24




**Diagrama 18:** Të ftuarit në edicione lajmesh në News 24

Kanali televiziv ABC News, ka një përfaqësim më të ekuilibruar mes të ftuarve nga qeveria, institucionet menaxhuese të pandemisë dhe përfaqësuesve të kategorive të tjera si dëshmitarë, ekspertë. Ajo që bie në sy në ABC News është se opozita ka edhe përfaqësimin më të madh për sa i përket të ftuarve (12), krahasuar me kanalet e tjera qoftë gjeneraliste kombëtare, qoftë me kanalet me informacion të pandërprerë.

i ftuari është:	ABC News
qeveritar/politikan i partisë në pushtet	8
nëpunës i institucioneve të menaxhimit të epidemisë	1
ekspert (mjek, psikolog, epidemiolog, etj)	12
politikan i opozitës	12
dëshmitar (i sëmurë, familjar)	2
shoqëri civile	3
të tjerë	9
nuk ka të ftuar	29
lidhje Skype me jashtë Shqipërisë	12


**Tabela 21.** Të ftuarit në edicione lajmesh në ABC News

1.C-6  
ABC News**Diagrama 19.** Të ftuarit në edicione lajmesh në ABC News

Kanali televiziv Ora News, është i balancuar në nivelin e përfaqësimit mes ekspertëve, përfaqësuesve të institucioneve të menaxhimit të pandemisë dhe përfaqësuesve të qeverisë si dhe kategorive të tjera përtej tyre. Por numri i të ftuarve si dëshmitarë, të sëmurë apo familjarë të tyre dhe shoqërisë civile është inekzistent në rastin e parë (0), dhe shumë i ulët në rastin e dytë (2).

i ftuari është:	ORA News
qeveritar/politikan i partisë në pushtet	11
nëpunës i institucioneve të menaxhimit të epidemisë	9
ekspert (mjek, psikolog, epidemiolog, etj)	24
politikan i opozitës	5
dëshmitar (i sëmurë, familjar)	0
shoqëri civile	2
të tjerë	17
nuk ka të ftuar	15
lidhje Skype me jashtë Shqipërisë	19

**Tabela 22.** Të ftuarit në edicione lajmesh në Ora News




**Diagrama 20.** Të ftuarit në edicione lajmesh në Ora News

Në kanalin televiziv Euro News më të përfaqësuarit janë ekspertët dhe të ftuarit nga kategori të tjera profesionale si dhe nga shoqëria civile.

i ftuari është:	Euro News
qeveritar/politikan i partisë në pushtet	9
nëpunës i institucioneve të menaxhimit të epidemisë	5
ekspert (mjek, psikolog, epidemiolog, etj)	22
politikan i opozitës	6
dëshmitar (i sëmurë, familjar)	1
shoqëri civile	4
të tjerë	13
nuk ka të ftuar	23
lidhje Skype me jashtë Shqipërisë	15

**Tabela 23:** Të ftuarit në edicione lajmesh në Euro News

### 1.C-8 Euro News




*Diagrama 21: Të ftuarit në edicione lajmesh në Euro News*

Ndërkohë që Report TV, shquhet për numrin e pakët të të ftuarve në përgjithësi, me një dominim të lehtë nga ekspertët dhe përfaqësuesit e partive politike.

i ftuari është:	Report TV
qeveritar/politikan i partisë në pushtet	4
nëpunës i institucioneve të menaxhimit të epidemisë	1
ekspert (mjek, psikolog, epidemiolog,etj)	7
politikan i opozitës	6
dëshmitar (i sëmurë, familjar)	4
shoqëri civile	1
të tjerë	6
nuk ka të ftuar	24
lidhje Skype me jashtë Shqipërisë	8

*Tabela 24. Të ftuarit në edicione lajmesh në Report TV*

### 1.C-9 Report TV



**Diagrama 22.** *Të ftuarit në edicione lajmesh në Report TV*

Edhe nga monitorimi i emisioneve televizive vihet re se pjesën mbizotëruese të të ftuarve e përbëjnë ekspertët vendas (175), funksionarë të qeverisë ose të partisë në pushtet (122) që po t'u shtojmë përfaqësuesit e institucioneve të ngarkuar me menaxhimin e pandemisë (74) përbëjnë edhe përqindjen më të madhe të të përfaqësuarve e më pas vijnë po ekspertët, por tashmë me banim jashtë vendit (131). Ndërkohë që përfaqësuesit e shoqërisë civile, gazetarët dhe të prekurit nga Covid 19 apo familjarët e tyre kanë një përfaqësim relativisht të ulët, përkatësisht, 17 dhe 25. Kategoritë e tjera profesionale apo shoqërore janë disi më të përfaqësuara në emisionet televizive (147). Publiku nuk është fare i përfaqësuar në emisionet televizive. Karakteristikë e emisioneve televizive të kësaj periudhe është se analistët e mediave, aktorët kryesorë të këtyre emisioneve para pandemisë kanë një pjesëmarrje thujse jo domethënëse (63).

Nga të dhënat e këtij monitorimi të paraqitura më poshtë shihet fare qartë se debati mediatik për Covid 19 është fokusuar në debatin në nivel ekspertësh për ecurinë dhe pasojat e sëmundjes si dhe për aspekte thjesht profesionale të menaxhimit të pandemisë. Por edhe aty këndvështrimet alternative të palëve kanë qenë dukshëm të pa stimuluar për shkak të shbalancimit të nivelit të përfaqësimit në favor të palës zyrtare.

## Të ftuarit në Emisione

Të ftuar	TV Klan	Top channel	Report TV	RTSH	ORA News	News 24	Euro News	ABC News	Vizion +	Total
Kryeministri	6	2	0	1	0	2	0	1	0	12
Funksionarë të qeverisë ose të partisë në pushtet	30	20	12	4	6	16	23	3	8	122
Funksionarë të institucioneve që menaxhojnë pandeminë	11	18	12	1	9	10	9	1	3	74
Eksper të: mjekë, epidemiologë, etj	39	36	10	5	23	16	29	9	8	175
Politikanë të Opozitës	16	10	0	2	13	5	17	2	3	68
Gazetarë	3	9	5	1	11	3	4	0	3	39
Shoqëri civile	1	0	4	0	5	2	5	0	0	17
Familjarë ose të prekur nga Covid-19	8	5	4	0	0	1	6	1	0	25
Publik në Shqipëri	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shoqëtarë, rezidentë jashtë Shqipërisë	39	26	10	1	17	5	24	2	7	131
Analistë	11	16	0	0	13	22	1	0	0	63
Të tjerë'	32	26	6	4	21	22	27	3	6	147
<b>Total</b>	<b>196</b>	<b>168</b>	<b>63</b>	<b>19</b>	<b>118</b>	<b>104</b>	<b>145</b>	<b>22</b>	<b>38</b>	<b>873</b>

Tabela 25. Të ftuarit në emisionet e kanaleve televizive shqiptare

DIAGRAMA 3.D  
TË FTUARIT NË EMISIONE TV




Diagrama 23. Të ftuarit në emisionet e kanaleve televizive shqiptare

Monitorimi i rubrikës së opinionëve të portaleve tregon se në ndryshim nga emisionet televizive të analizës këtu kolumnistët e rregullt dhe gazetarët mbajnë një peshë më të madhe në debatin për Covid 19 në Shqipëri. Në këto rubrika kolumnistët dhe gazetarët kanë përkatësisht 22% dhe 21% të artikujve. Ata janë më aktivë se mjekët (7%) dhe ekspertët e epidemiologjisë (1%). Debati për Covid 19 në portalet shqiptare është më i diversifikuar, dhe sillët rreth një problematike më të gjërë, më pak teknikist, por gjithësesi edhe këtu mungon kontekstualizimi social, ekonomik, kulturor. Megjithatë nga statusi social dhe politik i autorëve të opinionëve dhe analizave vihet re që debati është më pak i ndikuar dhe më i distancuar nga këndvështrimet e përfaqësuesve të qeverisë, insitucioneve të menaxhimit të pandemisë. Kjo tregon edhe njëherë faktin se mediat televizive për shkak të natyrës së pronësisë, janë më të kontrolluara nga qeveria. Pronarët e mediave televizive janë të gjithë aktivë në biznese të tjera përtej medias dhe siç është vënë re deri tani, i përdorin mediat si instrumente për t'i vënë në shërbim të qeverisë apo kundër saj, varësisht interesave ekonomike në bizneset e tjera.



	Nr artikujve	%	DOSJA	EXIT.al	Gazeta tema.al	Kohajonë .com	Lapsi.al	shqiptarja. com	Sot.com .al	Syri.net	gazeta dita.al
kolumnistë të rregullt	156	22%		26	78	4	3		28	11	6
mjekë	51	7%	1		26	9	3	2	1	8	1
ekspertë të epidemiologjisë	7	1%			3		1			2	
studiuues të shkencave sociale	26	4%			8	2	1		3	6	6
përkthyer nga mediat e huaja	93	13%	3	1	50	15	2	2	9	3	8
politikanë	133	19%	1	1	67	22		2	3	33	
gazetarë	146	21%	5	3	90	14	2	8	13	9	2
të tjerë	64	9%		5	22	12		1	18	4	2
marrë nga statuset në FB	22	3%	1			15			3	1	1
<b>TOTAL</b>	<b>698</b>	<b>100%</b>	<b>11</b>	<b>36</b>	<b>344</b>	<b>93</b>	<b>12</b>	<b>16</b>	<b>78</b>	<b>77</b>	<b>26</b>

**Tabela 26:** Artikujt në portale sipas statusit socio-profesional të autorëve të tyre

### 3. Vrasja e lajmit dhe e profesionit të gazetarit

Lajmi si gjini informative qëndron në disa themele si paanshmëria, saktësia, ndershmëria. Pikërisht këto standarte të gazetarisë u goditën rëndë gjatë pandemisë së Covid 19. Ky konstatim vjen si pasojë e rezultateve të monitorimit, kryesisht përmes ndjekjes së burimeve të informacionit të cilave u referoheshin lajmet për Covid 19 në Shqipëri. Nga monitorimi rezulton se pjesa më e madhe e lajmeve kanë si burim të vetëm deklaratat zyrtare të kryeministrit, të insitucioneve qeveritare, të partive politike, të pushtetit lokal, kryesisht të Bashkisë së Tiranës. Nuk ka balancim burimesh me burime alternative, pra nuk ka paanshmëri, nuk ka verifikim të informacionit pra nuk ka saktësi, nuk ka gjurmim të vërtetës përtej versionit zyrtar të së vërtetës, pra nuk ka ndershmëri. Pa këto standarte deontologjike a mund të quhen pjesa më e madhe e informacioneve të transmetuar lajme, dhe a mund të quhet ajo që u prodhua gjatë karantinës gazetari? Le t'u referohemi rezultateve të monitorimit të paraqitura të gjitha në mënyrë të kontekstualizuar e në raport me njëra tjetrën e veç e veç, për ta kuptuar më mirë dukurinë:

**Burimi i lajmit**

Lajmi lokal mbi Covid-19 bazohet (është):	Report TV	Euro News	ORA News	ABC News	Vizion +	News 24	Top channel	RTSH	TV Klan
Deklarata nga Institucione të pavarura (BSh, etj)	11	4	5	5	6	9	3	9	21
Deklarata nga institucione të huaja në Shqipëri	10	12	5	9	11	21	4	8	4
Deklarata nga Presidencia	6	6	15	8	10	24	5	17	10
Deklarata nga bashkitë e tjera	4	4	11	7	0	5	1	20	11
Deklarata nga Bashkia Tiranë	8	4	5	3	0	6	6	7	10
Reportazh nga terreni (spitale, pika kufitare, etj)	11	20	29	24	20	17	19	11	24
Lajm investigativ	0	2	0	1	0	0	0	0	0
Dëshmi nga të sëmurë e familjarë	4	1	8	8	1	5	6	1	2
Media qytetare (blogje, etj)	0	1	0	1	0	3	4	0	0
Deklarata zyrtare të Opozitës	13	15	26	23	38	49	18	36	31
Deklarata në FB të opozitës	13	1	9	4	3	22	3	2	10
Konferenca shtypi me gazetarë	1	3	0	1	0	2	0	0	0
Info nga nëpunës të institucioneve të menaxhimit Të pandemisë	11	7	10	16	0	3	24	15	14
Kronikë	38	30	69	40	72	75	79	78	74
Rrjetet sociale të Institucioneve qeveritare	21	23	25	9	2	13	4	38	34
Rrjetet sociale të KM	30	13	17	28	27	40	28	31	23
Deklarata zyrtare (KM, Ministrinë, IShP, Spitali)	57	67	75	63	79	76	80	75	84

**Tabela 27:** Burimet e lajmit





Diagrama 24. Burimet e lajmit

Të vizualizuara në grafikë dhe të shndërruara në përqindje, rezulton se një pjesë e lajmeve televizive kanë si burim të vetëm deklaratat zyrtare të kryeministrit, të ministrive, të ISHP-së, spitalit, nga nëpunës të institucioneve të menaxhimit të pandemisë, nga deklaratat e bashkive, nga deklaratat e Presidencës, opozitës. Një gazetari deklaratah, ku media nuk bën as më të voglin verifikim, thjesht përcjell tek qytetarët atë çfarë shpallin burimet zyrtare.


Në diagramat e mëposhtme gjenden me përqindje, pjesa dërmuese e burimeve të shndërruara në lajm sipas institucioneve.



**Diagrama 25:** Lajme me burim deklaratat zyrtare të kryeministrit, ministrive, ISHP-së, spitaleve

Po ti bashkosh përqindjet e mësipërme me përqindjet e mëposhtme rezulton se rreth 20-25% e lajmeve janë deklarata të institucioneve zyrtare. Natyrisht, jo vetëm në raste të tilla, por edhe në raste të tjera kohësh normale për shoqërinë, burimet zyrtare janë burim i detyrueshëm për gazetarët, por, të dhënat zyrtare merren, citohen


dhe konfrontohen me burime të tjera, të cilat të gjitha bashkë verifikohen përmes gazetarëve dhe vetëm pastaj i paraqiten publikut në një strukturë të mirëorganizuar lajmi.



**Diagrama 26:** Lajme me burim informacione nga nëpunës të institucioneve të menaxhimit të pandemisë


Edhe në rastet e informacioneve të shpërndara nga institucione të tjera si Presidenca e Republikës, apo partitë e opozitës mediat shqiptare reflektojnë të njëjtën sjellje. Kështu ata shndërrohen thjesht në përçues pa asnjë filtër të informacioneve të shpërndara nga të gjithë aktorët institucionalë të vendit, shpeshherë të vetëdijshëm se duke i përcjellë në mënyrë të barabartë të gjitha deklaratat e palëve, shfaqin pavarësinë dhe paanshmërinë para publikut, gjë që nuk është e vërtetë pasi pavarësia nuk qëndron në faktin se u shërbehet njësoj të gjitha palëve. Pavarësia dhe paanshmëria luhet në integritetin profesional të çdo lajmi, në raportin që gazetari dhe media ka me lajmin që prodhon.

1.B-25  
Deklarata nga Presidenca



**Diagrama 27:** Lajme me burim informacione nga Presidenca


1.B-17  
Deklarata zyrtare të Opozitës



**Diagrama 28:** Lajme me burim deklarata nga opozita

Edhe pushteti lokal, kryesisht bashkia e Tiranës në kohën e pandemisë ka qenë aktive në përdorimin e medias për të përhapur informacionet për veprimtarinë e bashkisë dhe veçanërisht të kryebashkiakut Veliaj përmes kanaleve kryesore televizive. Edhe më parë kryebashkiaku Veliaj është akuzuar për prodhimin e videove informative dhe shpërndarjen e tyre në media pa asnjë përpunim mediatik. Sipas monitorimit përqindja e lajmeve të mbështetura në informacionet e prodhuara nga Bashkia e Tiranës shkojnë nga 3.6% të lajmeve në 10%, shifër kjo e madhe po të kemi parasysh rolin jo të madh të bashkisë krahasuar me insitucionet e tjera të pushtetit qendror, në menaxhimin e pandemisë. Vetëm në një media kryebashkiaku Veliaj nuk ka qenë i pranishëm gjatë periudhës së karantinës.

1.B-22  
Deklarata nga Bashkia Tiranë




**Diagrama 29:** Lajme me burim informacione nga Bashkia e Tiranës

Citimi i burimeve është kriter i rëndësishëm për paanshmërimë e gjinive informative. Nisur nga të dhënat e mësipërme kuptohet fare qartë se kronikat televizive janë kryesisht të mbështetura vetëm në burimet zyrtare. Mungon thujse krejtësisht balancimi i




burimeve zyrtare me burime të pavarura apo alternative. Siç shihet nga diagrama e mëposhtme informacionet të mbështetura në deklaratat e institucioneve të pavarura janë shumë të pakta.

1.B-27  
Deklarata nga Institucione të pavarura (BSh, etj)



**Diagrama 30:** *Lajme me burim informacione nga institucione të pavarura*

Edhe referimi ndaj informacionit të prodhuar nga mediat qytetare është thujse inekzistent. Duket se sistemi i mediave tradicionale dhe sistemi i mediave qytetare funksionojnë si dy sisteme paralele, ku secila prodhon dhe riprodhon dy realitete të ndryshme. Sistemi i mediave tradicionale prodhon dhe riprodhon “realitetin” e parë nga distanca e pushtetit dhe e elitave politike, ekonomike, kulturore ndërkohë që mediat qytetare prodhojnë realitetin e qytetarit, të individit që shijon jo përfitimet e sistemit politik, por pasojat e tij.




**Diagrama 31:** *Lajme me burim informacione nga mediat qytetare*

Kjo “shpërfillje” e realitetit dhe e jetës së përditshme në kushtet e pandemisë dhe karantinës, prej mediave tradicionale reflektohet edhe në numrin e pakët të informacioneve të mbështetura në burime si dëshmitë e të prekurve nga Covid 19, të cilat mund të sillnin informacione për kushtet e trajtimit në spitale, për kostot ekonomike të familjeve të të sëmurëve nga njëra anë, por që nga ana tjetër, mund të shërbenin si burime alternative informacioni ndaj burimeve zyrtare. Po ashtu në ekranin e televizionit u informua shumë pak për pasojat ekonomike dhe sociale të shkaktuara nga marrja e masave kufizuese për parandalimin e Covid 19. Kjo shihet edhe nga rezultatet e monitorimit të paraqitura në diagramën e mëposhtme.

## 1.B-19

### Dëshmi nga të sëmurë e familjarë



**Diagrama 32:** Lajme me burim dëshmitë e personave të prekur nga Covid 19 apo pasojat e tij


Edhe nga monitorimi i rubrikave të aktualitetit të portaleve të monitoruara vihet re i njëjti anim drejt burimeve zyrtare. Një pjesë e madhe e informacionit (26%), vjen nga intervistat, lajmet dhe programet televizive. Kjo do të thotë që përmes marrjes së informacionit nga TV, merret bashkë me informacionin edhe prirja për mosbalancim të burimeve me anim të theksuar nga burimet zyrtare. Por, në portale dukuria rëndohet edhe më tej. Rreth 26% e informacionit të aktualitetit është transmetim deklaratash zyrtare. Deklaratat zyrtare zakonisht paraqiten jo të cituara në trupin e lajmit, por ashtu siç janë, në ndonjë rast me një shënim paraqitës nga gazetari i portalit ose edhe me ndonjë reduktim të pjesshëm të deklaratës. E njëjta gjë ndodh edhe me deklaratat e marra nga Facebook-u i politikanëve (7%), të cilat riprodhohen në portale thuajse pa ndryshim. Deklaratat e marra nga Facebook-u i kryeministrit zënë rreth 7% të të gjitha informacioneve të aktualitetit për Covid 19. Informacionet e marra nga Facebook-u i ekspertëve zënë vetëm 3%, pra 1% më pak se gjysma e atyre të marra nga Facebook-u i kryeministrit e akoma më pak ato të marra nga Facebook-u i qytetarëve - 1%.

BURIMI I INFORMACIONIT	Nr artikujve	%	DOSJA	EXIT.al	Gazeta tema.al	Kohajonë .com	Lapsi.al	shqiptarja.com	Sot.com .al	Syri.net	gazeta dita.al
Nga (intervista, lajme, programe)	2640	26%	191	90	270	953	70	152	581	247	86
Tv	88	1%	3	20	1	45	4	0	1	2	12
Konferenca shtypi	2676	26%	201	264	273	541	213	346	258	370	210
Deklarata Zyrtare	66	1%	1	12	9	36	0	0	1	5	2
Nga  Parlamenti	673	7%	22	66	137	159	57	48	20	75	89
FB i KM	174	2%	15	13	16	84	3	3	37	1	2
FB i institucioneve	698	7%	13	51	71	281	20	31	68	123	40
FB i politikanëve	343	3%	33	1	40	77	12	20	95	39	26
FB i ekspertëve	63	1%	15	0	8	8	5	0	6	28	3
Fb i qytetarëve											
përkthyer nga mediat e huaja	1797	18%	26	210	716	460	69	9	139	62	106
Lajme nga rajoni	334	3%	5	29	85	15	77	2	64	50	7
Burim i paspecifikuar	681	7%	32	19	9	278	7	60	123	18	135
<b>TOTALI i artikujve</b>	<b>10233</b>	<b>100%</b>	<b>557</b>	<b>775</b>	<b>1635</b>	<b>2937</b>	<b>537</b>	<b>671</b>	<b>1393</b>	<b>1020</b>	<b>718</b>

Tabela 28: Burimet e lajmit në portale


Të dhënat e mësipërme, tregojnë se gazetaria dhe profesioni i gazetarit në kohën e karantinës u përkeqësuan dukshëm në parametrat profesionalë. Dukuria e shndërrimit të përmbajtjeve të PR-it në përmbajtje mediatike mori përmasa shumë të mëdha. Kjo bëri që informimi mediatik i qytetarëve për Covid 19, të përkeqësohej. Gjinia kryesore informative -lajmi, në kuptimin profesional të tij zuri një vend shumë të vogël në tërësinë e përmbajtjeve informative të transmetuara nga mediat televizive shqiptare. Raportimi nga terreni ishte në një përqindje shumë të vogël, krahasuar me informacionin me bazë deklaratat apo videot e aktorëve politikë dhe institucionalë të ardhur në redaksi. Këtë e tregojnë edhe diagramat e mëposhtme. Shikoni se në ç’përqindje të ulët është sasia e kronikave dhe e lajmeve të prodhuara nga gazetarë në terren krahasuar me totalin e përmbajtjeve informative të transmetuara nga kanalet televizive shqiptare: informacioni i prodhuar nga gazetarët në terren në gjininë e reportazhit shkon sipas monitorimit nga 6% deri në 17%.

### 1.B-21 Reportazh nga terreni (spitale, pika kufitare, etj)



**Diagrama 33:** Reportazhe nga terreni (spitale, pika kufitare etj.)


Ndërkohë që raportimet me përmbajtje pastërtisht gazetareske shkojnë nga 5% e totalit të informacionit në 14% të po këtij totali.



**Diagrama 34:** *Kronika*

Lajmi investigativ pothuajse u zhduk nga ekranet televizive shqiptare. Në gjithë periudhën tremujore të pandemisë u prodhuan vetëm tre lajme investigative dy nga kanali televiziv Euro News dhe një nga kanali televiziv ABC News. Për një sistem mediatik të konsoliduar, momentet e krizave janë pjellore për gazetarinë investigative. Pandemia ishte një e tillë. Për shkak të masave të marra për përballimin e pandemisë, një sërë të drejtash dhe lirish u pezulluan përkohësisht. Aty ku ka forcim të rolit të qeverisë e vetmja mënyrë për t'i mbajtur në kontroll institucionet publike është një media profesionale që mbikqyr punën e tyre dhe e raporton atë para qytetarëve.


## 1.B-20 Lajm investigativ



**Diagrama 35:** Lajmi investigativ në mediat e monitoruara

Ndërkohë që mikrofonin dhe kamerat e gazetarëve ishte përdorur tërë kohën tek aktorët institucionalë e politikë, ata që vuanin më së shumti nga pasojat e pandemisë, të sëmurët, të mbeturit pa punë, bizneset e falimentuara, dhe të gjitha shtresat e popullsisë në përgjithësi u mbajtën larg ekraneve. Gazetarët me kamerat dhe mikrofonët e tyre sollën shumë pak nga jeta e qytetarëve. Sipas monitorimit, lajmet me burim qytetarë që vuanin pasojat e pandemisë ishin shumë të pakta në ekranet televizive.

## 1.B-19 Dëshmi nga të sëmurë e familjarë




**Diagrama 36:** Lajme me burim dëshmitë nga të sëmurë e familjarë

#### 4. Zhdukja e konferencave të shtypit. Nëse do, më ndiq në ekranin e TV-së apo në Facebook.

Gazetarët e kishin të vështirë të merrnin informacione në terren dhe po aq të pamundur për t'u bërë pyetje përfaqësuesve të qeverisë apo të institucioneve të menaxhimit të pandemisë nga konferencat e shtypit. Zhdukja e konferencave të shtypit nuk lidhet vetëm me kushtet e distancimit social të diktuar nga Covid 19. Në Itali, kryeministri Antonio Conte, i jepte konferencat e shtypit virtualisht ndërkohë që Komiteti i Ekspertëve i Italisë jepte konferenca të përditshme shtypi me gazetarë në një sallë që garantonte distancimin social por nga ana tjetër krijonte mundësi për konferenca shtypi përballë gazetarëve. Në Shqipëri, Komiteti i Ekspertëve i jepte konferencat pa praninë e mediave ndërsa kryeministri komunikonte vetëm përmes rrjeteve sociale.

##### 1.B-15

#### Konferenca shtypi me gazetarë




**Diagrama 37:** Lajme me burim konferencat e shtypit


Në mungesë të konferencave të shtypit gazetarët duhet të informoheshin për gjendjen e pandemisë apo për vendimet e institucioneve nga rrjetet sociale të kryeministrit Rama apo të institucioneve qeveritare. Lajmet me burim kryesor rrjetet sociale të kryeministrit shkojnë nga 5 deri në 17%, ndërkohë që lajmet me burim



kryesor institucionet qeveritare shkojnë nga 1 deri në 20%. Mbetet pra i njëjti problem: deklaratat – lajme të prodhuara nga institucionet qeveritare transmetohen si lajme deklarative nga mediat.



**Diagrama 38:** Lajme me burim rrjetet sociale të kryeministrit



**Diagrama 39:** Lajme me burim rrjetet sociale të institucioneve qeveritare

## IV. Përfundime

---

Përfundimet e këtij studimi mbështeten në monitorimin e edicioneve informative dhe emisioneve të kanaleve kombëtare televizive dhe atyre me informacion të pandërprerë. Në këtë monitorim u përfshinë edhe portalet kryesore informative shqiptare.

Nga monitorimi dhe analiza e rezultateve dalin në pah dukuri dhe trende për cilësinë dhe standartet e informimit të qytetarëve në periudhën e karantinës.

Mediat shqiptare të monitoruara janë gjendur para sfidave dhe vështirësive të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë. Industritë mediatike janë gjendur para vështirësive, së pari ekonomike, për shkak të rrudhjes së recetës publicitare nga bizneset e vendit një pjesë e madhe e të cilave e mbylli ose e ndërpreu aktivitetin ekonomik. Kjo ka sjellë përkeqësimin e gjendjes ekonomike të gazetarëve dhe humbjen e vendeve të punës në disa raste.

Megjithatë mediat e monitoruara kanë vazhduar misionin e tyre të informimit të qytetarëve edhe në kushtet e pandemisë. Informacioni për Covid 19 ka zënë rreth 70% të përmbajtjeve informative të mediave të monitoruara. Nga ky informacion, rreth 20-25% ka qenë informacion global. Si asnjëherë tjetër qytetari shqiptar ka qenë i informuar për aktualitetin ndërkombëtar. Informacioni për shkak se është prodhuar nga media ndërkombëtare me standarte profesionale dhe etike ka qenë i një cilësie relativisht të lartë.

Informacioni nga vendi, përkundrazi ka qenë shumë larg kësaj cilësie, për shkak të mungesës së aksesit në informacion nga ana e gazetarëve. Informacioni ka qenë shumë pak divers dhe nuk ka

ushqyer me informacion të larmishëm qytetarët shqiptarë. Nga pikëpamja tematike ky informacion ka mbuluar shumë ngushtësisht vetëm ecurinë e pandemisë, apo menaxhimin e saj por nuk ka arritur të informojë gjerësisht dhe thellësisht për pasojat e shumta ekonomike, sociale, kulturore të shkaktuara nga Covid 19.

Nga monitorimi rezulton se mediat shqiptare kanë bërë regres në standartet profesionale të raportimit të lajmit. Në një masë të madhe lajmi i prodhuar në mediat shqiptare ka qenë me burime të pabalancuara, i paverifikuar dhe rrjedhimisht i njëanshëm. Ai është mbështetur kryesisht në deklaratat e aktorëve institucionalë dhe shtetërorë madje në pjesën më të madhe janë konsideruar lajme deklaratat e këtyre aktorëve. Gjinitë klasike të informimit mediatik si lajmi apo reportazhi kanë pësuar regres dhe përbëjnë vetëm rreth 20% të përmbajtjeve mediatike të transmetuara. Informacioni i prodhuar nga mediat është shumë pak produkt i mbledhjes së informacionit në terren nga gazetarët.

Gazetaria investigative ka qenë pothuajse inekzistente. Vetëm tre lajme investigative janë prodhuar gjatë kësaj periudhe.

Mbështetur në rezultatet e monitorimeve të paraqitura më sipër mund të themi se gjatë pandemisë, mediat shqiptare nuk kanë arritur të informojnë në mënyrë cilësore qytetarin shqiptar për punën dhe funksionimin e institucioneve, por në shumë raste janë shndërruar në instrumenta të PR-it të institucioneve qeveritare.

